

# MENDIMI SHOQËROR, POLITIK DHE FILOZOFIK SHQIPTAR I VITEVE

1870-1945 (LMZ)

**Titullari /pedagogu i lëndës:** Dr. Majlinda Keta

**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orëmësimore;

**Tipologjia e lëndës:** C

**Viti akademik:** 2023-2024/

**Lloji i lëndës:** Lëndë me zgjedhje

**Programi i studimit:** Bachelor nëgjuhëgjermane

**Kodi i etikës:**Kodi i etikësi UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**Adresa elektronike e titullarit/ e pedagogut të lëndës:**majlindaketa@yahoo.com

## PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Përmes këtij moduli lëndor synohet të sjellim një formim identitar filozofiko shoqëror të studentëve shqiptarë me qëllim që të kontribuojë në edukimin me identitet kombëtar dhe europian bazuar në mendimin dhe analizën kritike të mendimtarëve kontributorë në këto vite në fokus të studimit.

Besimi në këtë kontribut bazohet në pohimin se mendimi dhe filozofia politike mund të përcaktohet si një refleksion filozofik mbi historinë e mendimit dhe programeve të zhvillimit të vendit shtrirë në histori, gjë që do të mundësonte lindjen dhe fuqizimin e ideve mbi menaxhimin më të mirë të mundshëm të jetës sonë kolektive, institucioneve shoqërore dhe politike si dhe praktikat sociale, bazuar mbi vlerat njerezore si të drejtat e njeriut, liria, drejtësia, patriotizmi, barazia, dinjiteti në historinë e një kombi.

Qasur këtij moduli do të vijë ndërtimi i debatit dhe krahasimi i modeleve “Orient apo oksident” të realizuara apo ofruara për çështje dhe modele të zhvillimit të vendit në këto vite, debat dhe dilemë kjo e ofruar nga plejada e mentorëve përmes botimeve të tyre.

Moduli mundëson që të diskutohet, debatohet për Shqipërinë Europiane të ideuar nga kjo plejadë mentorësh në këto vite dhe të krahasohet me standardet e sotme që kërkon procesi i integritetit europian të vendit.

Moduli do të hedhë ide dhe vlerësime mbi përvojën dhe kontributin e mendimit politik shoqëror filozofik shqiptar, në cilësi mentorësh e programatorësh alternativash zhvillimi në 3 periudha të mëdha të historisë së vendit:

1. kur filloi të ideohej pavarësia e shqiptarëve nga Turqia drejt shtetformimit,
2. kur u shpall Pavarësia dhe filloi shtetformimi
- 3.pas pushtimit të Italisë fashiste në 1939 deri në 1945 në raport me modelet e shtetit dhe programet e zhvillimit nën këtë kontekst ngjarjesh.

Moduli synon:

Të krijuarit e një mjedisi të nxënies së dijes universitare që familjarizon studentët me mendimin politik, shoqëror, filozofik shqiptar dhe ushtrimin e procesit të të filozofuarit mbi problematika shoqërore, cilësi dhe lloje institucioneve shoqërore apo shtetërore, alternativa zhvillimi të ndryshme shoqërore të atëhershme dhe të sotme.

Të krijuarit e një programi sfidant, motivues dhe të pranueshëm, rezultativ në nxënie nga nivele kuptueshmërie të vlerësueshme, shprehish apo interesash të ndryshme që studentët kanë referuar në ide dhe shkolla mendimi mbi identitetin kombëtar, europian të shqiptarëve dhe kontributet e këtyre mendimtarëve për një Shqipëri në zhvillim e identitet.

Të mbështeturit e procesit së nxënies nga studentët mbi lëndën studimin dhe kërkimin shkencor në këtë periudhë mbi figura, ide, teori të zhvillimit dhe botime.

Të krijuarit e një atmosphere ku objektivat e lektorit dhe studentit të ndihmojnë palët në punën e tyre të pavarues kërkuese shkencore dhe kontribute publike në auditore të hapura studentore apo mediatike

Të modeluarit e epërsive që i jep metoda e arësytimit filozofik në njohuritë e tyre për mendimin politik shoqëror shqiptar të kësaj periudhe për të kuptuar më mirë zhvillimet e sotme.

Të krijuarit e shprehive të transferueshme që i duhet një studentit për punë të pavarur, në grup bazuar në shprehite e analizës, mendimit kritik, artikulimit të argumentit “pro” dhe “kundër”, aftësive debatuese po aq sa dhe deklarimit të bindjes dhe mbrojtjes së saj për një angazhim personal e në grup për jetën komunitare.

Të aftësuarit në prezantim kërkimi shkencor të pavarur, në grup apo individual.

Objektivat e lëndës

Në përfundim të këtij kursi student duhet:

1. Të analizojë në mënyrë kritike idetë dhe shkollat e mendimit nga mendimtarë të këtyre vite në aspektin filozofik, sociologjik dhe politik zhvillimor.
2. Të përdorë aktivisht shumësinë e burimeve të literaturës për të ndërtuar prezantimin e analizës së vet të pavarur(individualisht apo në grup) për mendimtarët, përfshirë këtu edhe Biblioteka Kombëtare online.
3. Të aftësohet në krijimin e marrëdhënieve dialoguese, debatuese me studentë të tjerë apo në auditor publikme të ftuar duke u bazuar në parimet etike dhe të të menduarit kritik.